




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Deçanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Deçanit (KD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Deçanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Shpalosjet e detyrimeve kontigjente nuk ishte e plotë dhe e saktë ngase ishin mbivlerësuar për 2,009,250€.
- B2 Në 14 raste të pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendimet përmbartimore në vlerën 308,550€ që për nga natyra e shpenzimit i takojnë mallra dhe shërbimeve janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale.
- B3 Shpalosja e pasurive jo financiare në PFV nuk ishte e plotë dhe e saktë, ngase ishin nënvlerësuar për mbi 49,000,000€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Deçanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të mjeteve financiare.
- A2 Kontraktimi në mungesë të projektit ekzekutiv.
- A3 Mangësi në realizimin e pagesave përmes vendimeve/urdhërave përmbarimor.
- B4 Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari.
- B5 Emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Deçanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Deçanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Deçanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Deçanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Deçanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet për përmirësim rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Procesi i raportimit në komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur me rastin e përgatitjes së PFV-ve. Përkundër kërkesës sonë edhe pasqyrat financiare të korrigjuara nuk kanë arritur pritëshmëritë kjo dhe për faktin se regjistrat financiar të pasurive ende nuk janë të plotë përfshirë ceshtjet tjera. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në, pasuritë jo financiare, të hyra, detyrime kontigjente, ekzekutimin dhe klasifikimin e shpenzimeve, si dhe në procedurat e prokurimit publik të cilat janë paraqitur me poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre 3 janë rekomandime të reja dhe 9 janë rekomandime të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente në PFV

Gjetja

Rregullorja nr. 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore, nenit 18 përcakton se "Organizatave buxhetore në harmoni LMFPF-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente".

Shpalosjet e detyrimeve kontigjente nuk ishin të plota dhe të sakta, ngase ishin mbivlerësuar për 2,009,250€. Kemi vërejtur se në regjistrin e detyrimeve kontigjente janë përfshirë: 1 lëndë e cila me vendime gjyqësore është ekzekutuar nga Thesari në vlerë 64,000€. Po ashtu, në këtë regjister janë përfshirë edhe 12 lëndë në vlerë 1,945,250€, të cilat kanë vendim të plotfuqishëm nga gjykata, pa prapsim nga komuna dhe pritet ekzekutimi i pagesave nga Thesari.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, ngase kjo çështje ishte trajtuar edhe në raportin e vitit paraprak.

Ndikimi

Mos shpalosja e saktë e detyrimeve kontigjente ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre në PVF-të dhe mund të shpie në keqkuptimin e aktiviteteve financiare të komunës.

Rekomandimi B1

Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në mbivlerësimin e detyrimeve kontigjente për të siguruar se shpalosjet e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Në 14 raste të pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendimet përbarimore në vlerën 308,550€ që për nga natyra e shpenzimit i takojnë mallra dhe shërbimeve janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale. Kryesisht këto shpenzime kishin të bëjnë me furnizime me inventar dhe shërbime të ndryshme. Kjo ka rezultuar në mbivlerësimin financiar të shpenzimeve të kategorisë së investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e kategorisë së mallra dhe shërbimeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos planifikimit të duhur të buxhetit për detyrimet e mundshme në kategorinë përkatëse ekonomike.

Ndikimi Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori jo të duhura/përkatëse ekonomike ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të pozitës financiare të komunës përmes PFV-ve.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinoohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Mangësi në regjistrat e pasurive kapitale dhe jo kapitale**

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 6.1 përcakton që: “çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj, tutje neni 6.3 përcakton që: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria”.

Kemi identifikuar se në regjistrin e SIMFK-së për pasuritë jo financiare kapitale të blera gjatë viteve (2020-2023) nuk ishte bërë regjistrimi i plotë i tyre në vlerë mbi 9,000,000€, po ashtu, nuk ishin regjistruar dhe pronat komunale/tokat të vlerësuara mbi 40,000,000€. Në regjistrin e e-pasurisë të pasurive jo financiare jo kapitale nuk ishin të regjistruara pasuritë e plota të këtij viti dhe viteve paraprake përfshirë; administratën, drejtorinë e shëndetësisë (QMF-të) dhe të arsimit (shkollave).

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrollit të brendshëm për ti regjistruar pasuritë jo financiare në regjistrat përkatës.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të plotë dhe të saktë të pasurive jo financiare

shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur më pasuritë që posedon komuna, kjo ndikon në nënvlerësim të pasurive që rezulton në prezantimin jo të plotë, të saktë dhe të drejtë të informatave në PFV.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërin anë dhe departamentit të financave në anën tjetër për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale dhe PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të mjeteve financiare

Gjetja Ligji i prokurimit publik nr. 04/L-042, nenin 9 paragrafi 3 taksativisht normon se, nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla. Ligji i buxhetit nr. 08/L-193 për vitin 2023, neni 12 paragrafi 8 përcakton se; nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2023 dhe për dy (2) vitet në vijim.

Kontraktimet e projekteve në mungesë të mjeteve financiare janë identifikuar në këto raste, si në vijim:

- Në kontratën për “Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në fshatrat e komunës së Deçanit- Lloti III” e lidhur me dt. 13.04.2023 në vlerë 3,548,221€, fondet e buxhetuara në PIP për këtë projekt për vitin 2023 dhe dy vitet në vijim ishin 250,000€ (2023 në vlerë 200,000€, 2024 në vlerë 30,000€ dhe 2025 në vlerë 20,000€) dhe bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes MMPHI dhe komunës të datës 05.04.2023 ministria është zotuar që do të financoj këtë projekt në vlerë 700,000€ nga kjo rezulton në mungesë të fondeve për 2,598,221€ për realizimin e kësaj kontrate; dhe
- Në kontratën “Ndërtimi i pishinës së mbyllur gjysmë Olimpikë” e lidhur me dt. 08.08.2023 në vlerë 825,825€ fondet e buxhetuara në PIP për këtë projekt për vitin 2023 dhe dy vitet në vijim ishin 250,000€ (2023 në vlerë 100,000€, 2024 në vlerë 100,000€ dhe 2025 në vlerë 50,000€) nga kjo rezulton në mungesë të fondeve për 575,825€ për realizimin e kësaj kontrate.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

Ndikimi Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, nënshkrimi i kontratave për tej limiteve buxhetore dhe hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare të komunës ngase duhet të bëhen shumë përshtatje buxhetore dhe ri destinime të mjeteve për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve dhe rrit rrezikun e kostove shtesë.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë në përputhje me shumatat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet

në vijim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Kontraktimi në mungesë të projektit ekzekutiv

Gjetja Ligji i prokurimit publik nr. 04/L-042 ne neni 28.10 përcakton se: Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në kontratën “Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në fshatrat e komunës së Deçanit - Lloti III” e lidhur me dt. 13.04.2023 në vlerë 3,548,221€ është kontraktuar bazuar vetëm në paramasën dhe parallogarinë e tenderuar pa përfshirë lokacionet e kontraktuara në mungesë të projektit ekzekutiv.

Kontraktimi pa projekt ekzekutiv ka rezultuar në mungesën e lokacioneve të kryerjes së punimeve në paramasën e kontraktuar me elementet tjera përcjellëse.

Ndikimi Mungesa e lokacioneve dhe e projektit ekzekutiv në kontratat e ndërtimit ka ndikim direkt që gjatë realizimit të punimeve autoriteti kontraktues apo kontraktori mund të këtë paqartësi për lokacionet dhe specifikat tjera që shoqërojnë kryerjen e punimeve.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se lidhja e kontratave të punës (ndërtimit) të bëhet bazuar në projektin ekzekutiv mandator me qëllim të përcaktimit të saktë të lokacioneve dhe objektivave që do të arrihen në realizimin e projektit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në realizimin e pagesave përmes vendimeve/urdhërave përmbarimor

Gjetja Bazuar në rregulla financiare nr. 01/2013/MF Shpenzimin e parasë publike neni 15.1 taksativisht normon; Obligim do të thotë marrëveshje ligjore, siç është kontrata apo urdhër blerja në të cilën ka hyrë Organizata Buxhetore, dhe e cila kërkon nga OB-ja që të bëj shpenzim. Po ashtu neni 23.2 përcakton se: Raporti i pranimit mallit /shërbimit nga zyrtari / komisioni i autorizuar duhet të dorëzohet Zyrës për buxhet dhe Financa (së bashku me kontratën dhe urdhërblenjen).

Gjatë testimit kemi vërejtur se katër (4), faturat në vlerë prej 73,586€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor si rezultat i mungesës së raportit të pranimit dhe kontratave për mallrave, furnizimet dhe shërbimet e kryer nga OE. Raste kanë të bëjnë (shërbime të pajisjeve të zërimit ndriçimit për evente, për furnizime materiale të ndryshme, për shërbime me tenda dhe karrika për manifestime dhe furnizime me inventar), për këto raste kishte

urdhër përbarimor si në vijim:

- Vendimi/urdhëri për transfer përbarimor P.nr. 178/23 i datës 01.09.2023 më borgjin kryesor 9,580€ për shërbime të pajisjeve të zërimit ndriçimit për evente ishte bazuar vetëm në faturë të pranuar nga komuna, nuk kishte raport të pranimit (konstatim) dhe kontratë për ofrimin e këtyre shërbimeve;
- Vendimi/urdhër për transfer përbarimor P.nr. 206/23 i datës 12.04.2023 me borgjin kryesor 9,831.94€ për furnizime materiale të ndryshme ishte bazuar vetëm në faturë të pranuar nga komuna, nuk kishte raport të pranimit (konstatim) dhe kontratë për ofrimin e këtyre shërbimeve;
- Vendimi/urdhëri për transfer përbarimor P.nr. 34/23 i datës 10.02.2023 me borgjin kryesor 11,805€ për shërbime me tenda dhe karrika për manifestime, ishte bazuar në fatura të pa specifikuara në faturë për llojin e tendave faturuara, nuk kishte raport të pranimit (konstatim); dhe
- Vendimi/urdhëri për transfer përbarimor P.nr. 239/22 i datës 14.10.2022 me borgjin kryesor 42,370€ për furnizime me inventar të ndryshëm ishte bazuar në faturë e cila i referohej çmimit total të fletdërgesave (e jo sasive dhe çmimeve për njësi që duhet të përbejnë faturën, për më tepër përveç fletdërgesave nuk kishte raport të pranimit (konstatim) dhe kontratë për furnizimin e inventarit.

Ekzekutimi i vendimeve përbarimore është bërë si shkak i pranimit të faturës nga OB si dokument i besueshëm për ekzekutim nga përbaruesi dhe kjo ka rezultuar si pasoj dhe e pranimit të faturave/ës pa u siguruar paraprakisht raporti i pranimit dhe kontrata.

Ndikimi	Mungesa e kontratës dhe raporteve të pranimit si dokumente qenësore në procesin e ekzekutimit të buxhetit, ndikon në mundësinë e keqpërdorimit të parasë publike edhe për shpenzimet shtesë të procedurave përbarimore.
Rekomandimi A3	Kryetari duhet të sigurojë së pari që të gjitha mallrat dhe shërbimet kontraktohen paraprakisht dhe bëhet pranimi i autorizuar sipas kushteve kontraktuale, para veprimeve tjera në shpenzimin e parasë publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari

Gjetja	Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi (LMFPP) nr. 03/L-048 neni 39.1 përcakton se; çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës. Ndërsa sipas nenit 40 fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përbaruesi. Po ashtu ligji për marrëdhëniet detyrimeve nr. 04/L 077 neni 382.2 taksativisht parasheh; Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Gjatë testimit të pagesave të ekzekutuara nga komuna kemi vërejtur se në nëntë (9) raste në vlerë 806,803€ të pagesave të cilat kanë kaluar afatin ligjor prej 30 ditësh për ekzekutim. Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur se ka pasur kërkesa për inkasimin e mjeteve nga OE përmes procedurave përbarimore/gjyqësore. Megjithatë, nga analiza e raportit të shpenzimeve
---------------	---

kemi vërejtur se përmes procedurave përmbarimore/gjyqësore dhe në bazë të vendimeve gjyqësore, Thesari kishte ekzekutuar 2,149,951€. Kjo formë e pagesave, përveç keqklasifikimit, ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve të procedurave përmbarimore dhe interesit. Vetëm në një rast, vendim/urdhër përmbarimor P.nr. 44/2023, për vonesën e pagesave të obligimeve, është aplikuar interesi në kamatë vonesë në vlerën 63,587€.

Hyrja në obligime është si shkak i kontraktiveve dhe realizimeve të punëve pa pasur buxhet të mjaftueshëm dhe mos përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mosrealizimin e pagesave brenda afatit kohorë ligjor që ka rezultuar më pagesën e tyre përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore më shpenzime shtesë për procedurat përmbarimore dhe kamatëvonesat.

Ndikimi Si pasojë e vonesave në pagesa dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar likuiditetin e saj nga vendimet përmbarimore përmes thesarit ka ndikim direkt në rritjen e kostos për komunën.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme

Gjetja Ligji i punës nr. 03/L-212, neni 10, paragrafi 6 përcakton se, Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë (120) ditë brenda një (1) viti, Ligji për Zyrtarët Publik nr.06/L-114, neni 84 përcakton se, Marrëveshjet për shërbime të veçanta, sipas paragrafit 4 të nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në ato marrëveshje në pajtim me dispozitat e lartcekura. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet për shërbimet e veçanta lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik.

Gjatë vitit Komuna kishte angazhuar 51 punonjës përmes Marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MShV), prej tyre 41 në administratën komunale në zyrën e kryetarit dhe drejtori të ndryshme, tetë (8) në shëndetësi, si dhe dy (2) në arsim. Për këta punonjës komuna nuk ka zhvilluar as procedurë formale të rekrutimit as procedura të prokurimit për MShV, por janë angazhuar me vendime të kryetarit të komunës. Për 41 punonjës kishte vendim për kohë të caktuar gjashtë (6) muaj, ndërsa 10 tjerë kishin vendim deri në përfundim të mandatit të kryetarit. Me datë 21.07.2023 Kryetari ka nxjerrë vendimin nr. 02/2023 për ndërprerjen e të gjitha kontratave dhe vendimeve të punëtorëve të angazhuar për shërbime të veçanta. Ndërkohë nga muaji gusht janë nxjerrë 27 vendime tjera për angazhim të punonjësve, 21 prej të cilëve ishin angazhuar edhe për një periudhë gjashtë mujore, dhe 6 (gjashtë) prej tyre për periudhën deri në fund të mandatit të kryetarit, në pozitat si: inspektor i nërtimeve; këshillëtar për media elektronike; asistente administrative; vozitës i ndihmes së shpejtë në QKMF; zyrtar për pranimin e mallit; dhe inspektor i veterinarisë. Të gjithë këta vazhdojnë të jenë të angazhuar edhe në vitin 2024.

Angazhimi i tyre nuk është bërë për shërbime të veçanta apo detyra specifike, por për pozita të rregullta të punës. Për këta punonjës komuna në

vitin 2023 ka paguar 204,660€.

Angazhimi i stafit pa procedura ka ndodhur për shkak se kanë mungesë të punëtorëve dhe pamundësisë së zhvillimit të procedurave të rekrutimit si dhe nevojave për mbulimin e pozitave pas pensionimit të disa punonjësve. Ndonëse duhet theksuar se kjo çështje trajtohet në vazhdimësi në raportet e auditimit.

Ndikimi

Emërimi i zyrtarëve për pozita të rregullta për periudhë të caktuar dhe angazhimi me kontrata për një detyre specifike me afat më të gjatë kohë dhe pa procedura është në kundërshtim me legjislacionin përkatës. Njëherit kjo rrit rrezikun e angazhimit të stafit jo kompetent për pozita të caktuara duke eliminuar konkurrencën dhe mundësitë e barabarta për punësim.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MShV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësitë kërkuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2023 ishin në vlerë 804,746. Ato kanë të bëjnë me kryesisht me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Çështja B6 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 dhe 11.4 4, përcakton se: Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. UA nr. 03/20211 për mbledhjen dhe regjistrimin e informative mbi pronën dhe tatimpaguesin, neni 7, paragrafi 1.1 kërkon numrin personal identifikues të tatimpaguesit fizik.

Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimin të Vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar se për 711 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 - "Zbritjet për vendbanim parësor", mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal.

Kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake dhe për shkak të stafit të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë nuk është arritur që të azhurnohen të dhënat në Protax.

Ndikimi Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përlogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të shtoj kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit. Pastaj të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit/azhurnimit të shënimeve në bazën e të dhënave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mos verifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve

Gjetja Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, neni 15, pika 2 përcakton se; Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Nga 7,033 objekte të evidentuara në bazën e të dhënave, komuna ka

regjistruar 222 prona të reja, si dhe kishte arritur të kryej 497 modifikime, gjithsej janë kryer 719 verifikime nga të gjitha pronat apo rreth 11%. Megjithëse në krahasim me vitin e kaluar ka ngritje për afër 10%, niveli i përqindjes së verifikimit është ende i ulët, prandaj kërkohen ende veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes në të terren.

Mos verifikimi i pronave mungesës së anketuesve në terren dhe kontrolleve të pa mjaftueshëm në sektorin e tatimit në pronë.

Ndikimi

Verifikimi jo i plotë i pronave për qëllime të tatimit në pronë, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 13,581,954€, pasurive jokapitale është 166,533€, si dhe e stoqeve 22,658€.

Çështja B8 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: çdo fundvit behet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, tutje neni 21 i kësaj rregullore ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive në regjistrat kontabël, rrjedhimisht nuk dihen diferencat në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Tutje nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare që ka të bëjë me vlerësimin e pasurive të dëmtuara, vlerësimin e kërkesave për tjetërsim të pasurive si dhe përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzueseve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

Ndikimi Mos krahasimi i rezultateve të rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi B8 Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Përveç planit strategjik, NJAB kishte hartuar dhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë 5 auditime të cilat edhe ishin realizuar gjatë vitit 2023. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit ishte 30, prej të cilave të zbatuara ishin 12, në proces ishin 8 dhe 10 ishin të pazbatuara. Auditimet ishin fokusuar në fushën e pasurisë, subvencioneve, menaxhimit e kontratave, rishikimi i proceseve të prokurimit dhe shpenzimet. Periudha e auditimit ishte kryesisht e mbuluar për vitin 2023. Komiteti i auditimit kishte mbajtur 4 takime, ku ishte diskutuar për punën dhe raportet e NJAB-së.

Çështja B9 - Mungesa e stafit dhe planeve të veprimit në adresimin e rekomandimeve të NjAB-s

Gjetja

Rregullorja 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, neni 5.1.1 përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë. Po ashtu, sipas Rregullores 01/2019 për Themelimin dhe zbatimin e auditimit të brendshëm neni 9, pika 7 - Auditorët e brendshëm monitorojnë zbatimin e rekomandimeve në mënyrë sistematike sipas planit të veprimit të miratuar nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik. Gjithashtu sipas nenit 10 pika 1.3 të së njëjtës rregulloreje - Është përgjegjësi e udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për auditimin e brendshëm për të siguruar zbatimin e rekomandimeve për të cilat janë pajtuar për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit.

NjAB në Komunën e Deçanit përbëhet nga drejtori dhe një anëtar, e që duhet të ketë së paku tre auditorë.

Njësitë e audituara nuk kishin përgatitur plane veprimi për adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm. Si rrjedhojë, rekomandimet e AB-së nuk ishin adresuar sa duhet nga menaxhmenti, ku nga 30 rekomandimet e dhëna për vitin 2023, 10 nga to nuk ishin adresuar, 8 ishin në proces, ndërsa 12 ishin zbatuar.

Kjo gjendje ishte për shkak mungesës së buxhetit të ndarë për plotësimin e numrit minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore. Ndërsa mungesa e planeve për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së ishte për shkak të neglizhencës dhe mos përgjegjësisë së zyrtarëve përgjegjës të drejtorive përkatëse.

Ndikimi

Mos kompletimi i NjAB-së me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik. Ndërsa, mungesa e planit të veprimit dhe ndërmarrja e veprimeve të pamjaftueshme nga menaxhmenti në adresimin e rekomandimeve mund të rezultojë me vazhdimin e dobësive të identifikuar, jo efikasitet në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi B9

Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB. Po ashtu, duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe njëherësh të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	12,119,805	13,727,206	13,362,912	10,801,693	9,785,496
Grante Qeveritare - Buxheti	11,021,320	12,388,227	12,369,409	9,713,779	9,098,298
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	94,003	32,434
Të bartura nga viti i kaluar	0	183,174	182,351	322,938	112,052
Të hyrat vetanake	1,098,485	1,098,485	775,302	669,476	530,712
Donacionet vendore	0	17,002	0	1,496	12,000
Donacionet e jashtme	0	40,318	35,850	0	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë / më i ulët se buxheti fillestar për 1,607,401€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së grantit të qeverisë për 1,366,907€, rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak për 183,174€, rritjes së donacioneve vendore për 17,002€ si dhe donacionet e jashtme për 40,318€.

Në vitin 2023 komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final 13,362,912€, me një përmirësim 1% në krahasim me vitin 2022.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	12,119,805	13,727,206	13,362,912	10,801,693	9,785,496
Pagat dhe mëditjet	5,800,000	7,166,907	7,166,907	5,934,913	5,779,575
Mallrat dhe shërbimet	2,100,000	2,128,575	1,997,058	1,844,173	1,619,414
Komunalitë	200,000	200,000	199,991	195,491	154,906
Subvencionet dhe transferet	200,000	208,028	207,422	152,100	172,625
Investimet Kapitale	3,819,805	4,023,696	3,791,534	2,675,016	2,058,976

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,366,907€. Rritja ishte si rezultat i vendimeve të qeverisë;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 28,575€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 27,553€ dhe nga donacionet për 1,022€;
- Buxheti final për shpenzime komunale nuk ka pasur ndryshime; dhe
- Buxheti final për subvencione dhe transfere për 8,028€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura vetanake; dhe
- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 203,891€. Rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura vetanake për 147,593€ dhe donacionet për 56,298€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga komuna në 2023 ishin në vlerë 804,746€ apo rreth 17% me shumë se vitin paraprak. Struktura e hyrave përbëhet nga të hyrat e tatimit në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	1,098,485	1,098,485	804,746	689,783	712,376
Të hyrat tatimore	726,771	726,771	505,170	387,433	473,002
Të hyrat jo tatimore	371,714	371,714	299,577	302,350	238,124
Të hyrat tjera	0	0			1,250

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 ka rezultuar në 17 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Mirëpo komuna nuk ka raportuar me kohë lidhur me zbatimin e rekomandimeve përmes raporteve periodike të zbatimit të rekomandimeve të cilat do të duhej të dorëzoheshin me 30.09.2023 dhe 15.03.2024.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, tetë (8) rekomandime janë zbatuar, ndërsa nëntë (9) rekomandime nuk ka filluar zbatimin, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e 4 të rekomandimeve.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në gabimet e shpalosjeve për detyrimet e papaguara dhe të sigurojë se të gjitha faturat pranohen përmes arkivit të komunës.	Për mangësi në shpalosjen e të dhënave në PFV referoju çështjes së detyrimeve kontigjente.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për tu siguruar që mjetet e paguara për këto qëllime kane shkuar në destinimin e synuar si dhe të forcojë kontrollet në ekzekutimin e pagesave për tu siguruar se nuk do të përsëriten rastet e tilla.	Janë ndërmarr masat e duhura.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtojë kontrollet në zyrën e prokurimit për të siguruar se stafi i caktuar në menaxhimin e procedurave të prokurimit janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik dhe se aplikojnë kontrollet në të gjitha fazat e tij.	Nuk kemi hasur në raste të njëjta.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtojë kontrollet në procesin e vlerësimit të aplikuesve për ndarjen e subvencioneve komunale për të siguruar se përfitojnë vetëm ata që plotësojnë kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.	Ka ndërmarr masat e duhura në vlerësimin e aplikacioneve të subvencioneve.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përbarimit.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtojë kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit. Pastaj të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të shënimeve në bazën e të dhënave.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë aplikimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e stafit për MShV. Si dhe, të sigurojë se kjo formë e angazhimit aplikohet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat janë të arsyeshme nga njësitë kërkuese.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të objekteve të paluajtshme në mënyrë që të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale në bazën e të dhënave për pronat ekzistuese të komunës. Mbledhja e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.	Verifikimi i 20% të pronave nuk është arritur as në vitin 2021.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë një koordinim më të mirë ndërmjet komunës dhe departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, me qëllim të përmirësimit të shënimeve në bazën e të dhënave. Po ashtu, Kryetari duhet të shtojë kontrollet që të sigurojë se bëhet vlerësim i saktë i tatimit në pronë për tatimpaguesit.	Rekomandimi i përsëritur i viteve të kaluara është përmbushëm në masë të madhe dhe në vitin 2023 ka pasur vetëm 28 ankesa të tatimpagueseve për ngarkesë të gabuar të tatimit, prandaj konsiderohet si i pa aplikueshëm më.	Nuk është i aplikueshëm më

10.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që subvencionimi i OJQ-ve bëhet përmes thirrjes publike siç përcaktohet me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve. Po ashtu, me rastin e ndarjes së subvencioneve të lidhë marrëveshje me përfituesit për tu siguruar se mjetet shpenzohen për objektivat e përcaktuara.	Ka pasur thirrje publike për OJQ këtë vit.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme ngase edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin e saktë të nevojave për punë dhe zbatimin e drejtë të kornizës ligjore të prokurimit publik. Po ashtu duhet të sigurojë se projektet e specifikuara nuk tejkalojnë paramasën e përllogaritur si në sasi ashtu edhe në vlerë ashtu siç janë përcaktuar me kushtet e kontratës.	Në pagesat e ekzekutuara nga komuna nuk kemi hasur në këtë dukuri.	I zbatuar
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë duke vendosur komunikimin ndërmjet zyrtarit të pasurisë në njërin anë dhe departamentit të financave në anën tjetër për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale dhe PFV.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.	Nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme ngase edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin

15.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Menaxhmenti i komunës ka ndërmarrë veprime për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme duke iu dërguar obliguesëve tatimor vërejtje të fundit për pagesën e borxhit para se të dërgohen në përmbarim.	Nuk është i aplikueshëm më
16.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet që kanë ndikuar në nënvlerësimin e detyrimeve kontingjente për të siguruar se shpalosjet e tyre janë të plota dhe të sakta në PFV.	Edhe këtë vit kemi evidentuar se ishte bërë nënvlerësimi i detyrimeve kontingjente.	Nuk ka filluar zbatimin
17.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB. Po ashtu, duhet të sigurojë përgatitjen e planeve të veprimit nga njësitë e audituara për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe njëherësh të sigurojë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.	Edhe këtë vit kemi evidentuar dukurinë e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Xhevat Seferi, Anëtar i ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter konfirmimi



Komuna e Deçanit
Municipality of Decan
Opština Dečan

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit


Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **KK- Deçan** për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bashkim Ramo
Kryetar i Komunës së Deçanit

Data: 11.06.2024, Deçan.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.